



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-056
Prishtinë, më 18 janar 2019, në orën 08:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 18 JANAR 2019

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Muferra Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca dhe Dardan Sejdiu.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerita Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes, kryetari u dëshiroi mirëseardhje të pranishmëve në punimet e Kryesisë së Kuvendit dhe organeve të tjera të Kuvendit në Sesionin pranveror.

Ai pastaj i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Në vazhdim, kryetari propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një (1) pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Rendi i ditës për seancë plenare,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 19 nëntor dhe 3, 4, 15 e 24 dhjetor 2018.

2. Rendi i ditës për seancë plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit se për seancë plenare në rend të ditës janë të përfshira pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme, si dhe pikat tjera që janë proceduar ndërkohë, e që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim.

Lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës, diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli; nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti; kryetari i GP të LDK-së, z. Avdullah Hoti; kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi, më 30 janar 2019, në orën 10:00, të mbajë seancë plenare, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*

4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për komunën e Podujevës,*
6. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për protokollin shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,*
7. *Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,*
8. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG për Projektin e ndërtimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për komunën e Ferizajt,*
9. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes,*
10. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës lidhur me financimin e Projektit ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë për komunën e Graçanicës,*
11. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut,*
12. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës,*
13. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,*
14. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave,*
15. *Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,*
16. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,*
17. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,*
18. *Votimi në parim i Projektligjit për peticione,*
19. *Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,*
20. *Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
21. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,*
22. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,*

23. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256,*
24. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve,*
25. *Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,*
26. *Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP të Partisë Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a. /NKEC,*
27. *Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributëdhënës,*
28. *Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI 08/09, datë 17 dhjetor 2010, vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-799, datë 19 mars 2014, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 08/186, dt. 29 prill 2014, i hyrë në fuqi më 12 maj 2014 dhe të dy (2) udhëzimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. C-V-14-4099 dhe nr. C-V-14-4332, datë 13 qershor 2014,*
29. *Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti,*
30. *Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.*

Po ashtu, kryearti konstatoi se Kuvendi do të mbajë edhe dy seanca plenare, njëra me 31 janar dhe tjetra në fillim të shkurtit, për rendin e ditës do ta caktojë Kryesia e Kuvendit në javën tjetër.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2019

Kryesia, pasi e shqyrtoi Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

2. Programi Legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2019 t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që mbi bazën e Programit Legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2019 dhe të propozimeve të veta t'i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2019 deri më 31. 1. 2019.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që në bazë Programit Legjislativ të Qeverisë së Kosovës dhe planeve të punës së komisioneve parlamentare ta hartojë Propozim-programin e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 deri më 10. 2. 2019, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit i procedohet seancës plenare për miratim.

2. Peticioni i qytetarëve të Komunës së Mitrovicës Jugore për nismën legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me peticionin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Peticioni i nënshkruar nga 16 594 qytetarë të Komunës së Mitrovicës Jugore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave i dërgohet për mendim Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

Kjo pikë u shty për mbledhje e radhës.

4. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-strategjinë e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Strategjia për informim dhe komunikim e Kuvendit të Republikës së Kosovës (2019 - 2021) "Kuvend i hapur, pjesëmarrje qytetare".

5. Propozimi i Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për miratimin e Strategjisë për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e politikës së jashtme

Kryesia, me propozim të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Strategjia e Kuvendit për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e politikës së jashtme, pa pikën 4.1.2, të cekur në Propozim-strategjinë e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike.

6. Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryesia e radhiti raportin e lartshënuar në rend dite për seancën plenare më 30 janar 2019.

7. Kërkesa e kryetarit të GP-të LDK-së për përfaqësimin e këtij grupi në delegacionin e Kuvendit të Kosovës në AP të Këshillit të Evropës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Grupi Parlamentar i LDK-së e ka propozuar deputetin Ismet Beqiri për anëtar të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli; nënkryetarët e Kuvendit; Kujtim Shala dhe Aida Dërguti, si dhe kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia, lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës është formuar mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve të Legjislaturës VI dhe kritereve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

8. Kërkesa e deputetes Ganimete Musliu për kompensimin lidhur me ushtrimin e detyrës si kryesuese e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kompensimet e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit në punën e komisioneve parlamentare janë rregulluar me vendim të Kryesisë së Kuvendit për caktimin e lartësisë së kompensimit të deputetit për funksion udhëheqës dhe kompensimin e shpenzimeve mujore.

9. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për kompensimin e anëtarëve të këtij komisioni

Kryesia vendosi që kërkesa e lartshënuar të radhitet në rend dite të seancës plenare të radhës.

10. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor të këtij komisioni

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor të këtij komisioni.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti; kryetari i GP të PDK-së, Memli Krasniqi; kryetari i GP të LVV-së, Glauk Konjufca dhe kryetari i GP të AAK-së, Ahmet Isufi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Mandati i komisioneve për hetim parlamentar është i rregulluar me nenin 6.3 të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar: “Mandati për hetimin e një çështjeje është gjashtë (6) muaj, brenda të cilit komisioni duhet të paraqesë raport përfundimtar”.

11. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyesve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës për zgjatjen e mandatit edhe për një afat dy (2) mujor të këtij komisioni

Po ashtu, edhe për kërkesën e lartshënuar, Kryesia, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Mandati i komisioneve për hetim parlamentar është i rregulluar me nenin 6.3 të Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar: “Mandati për hetimin e një çështjeje është gjashtë (6) muaj, brenda të cilit komisioni duhet të paraqesë raport përfundimtar”.

12. Kërkesa për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2019

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën për aprovimin e pjesëmarrjes së Delegacionit të Kuvendit të Kosovës në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për vitin 2019.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar, diskutuan: nënkryetarët e Kuvendit: Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Aida Dërguti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia me shumicë votash (katër (4) vota për dhe një (1) kundër, Kujtim Shala), mori këtë:

V E N D I M

Anëtarëve të delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: Xhavit Haliti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit, dhe deputeti Slobodan Petroviq, si dhe zëvendës-anëtarë: Mufera Srbica-Shinik, nënkryetare e Kuvendit dhe deputetët: Ismet Beqiri dhe Gani Dreshaj, u lejohet pjesëmarrja në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës sipas kalendarit të takimeve për vitin 2019, të bashkangjitur.

13. Kërkesa e Grupit të Deputetëve të Rinj për ndarjen e një zyre në hapësirat e Kuvendit për nevoja të këtij grupi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Administrata e Kuvendit që ta shikojë mundësinë eventuale për gjetjen e ndonjë zyre për Grupin e Deputetëve të Rinj.

14. Raportet e delegacioneve të Kuvendit të Kosovës lidhur me realizimin e vizitave zyrtare në Kanada dhe Francë

Kryesia u njoftua me shkrim nga delegacionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës për vizitat zyrtare të realizuara, si në vijim: në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në përbërje nga nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, e ka realizuar një udhëtim zyrtar në Halifax (Kanada), nga 16 - 20 nëntor 2018; në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në përbërje nga nënkryetarët e Kuvendit: z. Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti e kanë realizuar një udhëtim zyrtar në Paris (Francë), nga 10 - 14 dhjetor 2018; në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, deputeti Slobodan Petroviq e ka realizuar një udhëtim zyrtar në Paris (Francë), nga 12 - 14 dhjetor 2018.

15. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me realizimin e vizitave zyrtare në Maqedoni dhe në Mal të Zi

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal për realizimin e dy vizitave zyrtare: në Shkup (Maqedoni), prej 26 - 28 nëntor 2018 dhe në Podgoricë (Mal të Zi), prej 3 - 5 dhjetor 2018.

16. Njoftimi i anëtares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Sarajevë

Kryesia u njoftua me shkrim nga anëtarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, për realizimin e vizitës zyrtare Sarajevë (Bosnjë-Hercegovinë), prej 13 - 15 nëntor 2018.

17. Deklarata e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në lidhje me ndalimin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Slobodan Petroviq, nga policia serbe në kalimin e kufirit Kosovë-Serbi

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim për nxjerrjen e një deklaratë në lidhje me ndalimin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Slobodan Petroviq, nga policia serbe dhe mbajtjes për disa orë duke u marrë në pyetje nga pjesëtarë të Shërbimit Informativ Serb, gjatë kalimit të kufirit Kosovë-Serbi, më 8 dhjetor 2018.

Pika shtesë:

1. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Arben Gashi, Memli Krasniqi dhe Dardan Sejdiu u lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington D.C. SHBA, për pjesëmarrje në “Lutjet e Mëngjesit”, prej 4 - 10 shkurt 2019, ndërsa deputetit Slobodan Petroviq nga data 3 - 10 shkurt 2019.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, të pjesëmarrjes dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale